REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 911/19
Datë/Datum. 26.12.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi Agim SHEQIRI	Data e autorizimit të ekspertit 16.12.2019	Data e dorëzimit të raportit 26.12.2019	Nr. i lëndës:Nr 911/19

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.12. 2019, OE."Rojet e Nderit , ka parashtruar ankesë me nr: 911/19, kundër vendimit për dhëni të kontratës OE, Commando" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve te Spitalit të Përgjithshëm Prizren" me nr.prok: 70010-19-5052 - 2-1-1 iniciuar nga AK - Spitali Regjional-Prizren .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur për shërbime , vlera e parashikuar e kontratës: 470,911.68€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Konsiderojmë se ju, si Autoritet Kontraktues, me ose pa vetëdije, kërcënoni të shkelni:

Neni 6 Ekonomiciteti dhe efikasiteti
Neni 7 Barazia ne trajtim/jo diskriminim
Neni10 mjete për promovim te transparencës
Neni 59 ekzaminimi dhe vlershmi i tenderit
Neni 60 të LPPsë

Me datë:22.11.2019 kemi pranuar njoftimin për eliminim nga ana juaj për arsye si më poshtë:
Mungon raporti mbi pajsjet teknike,
Ky pretendim i juaji nuk qëndron pasi që ne konform kërkesës tuaj ku keni
cekur:
Evidenca 6 Pika a) të dëshmohet me licencë, raport dhe foto për secilën - (kopje). SHËNIM Në lidhje me këtë pikë (nr.6), ky kriter mbulohet me Licencën për Shërbime Themelore të Sigurisë, konform Ligjit 04 L-004, duke ia bashkangjitur edhe si dëshmi një raport mbi paisjet teknike me fotografi dhe vendim të MPB-së. OE po ashtu duhet të dëshmoj se ka pajisje dhe uniforma të mjaftueshme në dispozicion përmes një deklarate. AK mund të kërkoj që ne çdo çast të vie në zyre e

kompanive për verifikim. Si dhe ruan të drejtën e verifikimit dhe të kontrollit të çdo lloj infomacioni të dhënë nga OE për këtë proces të Prokurimit. Pika b) të dëshmohet me leje të punës (kopje).
Sipas formularit të tenderit ju në Folderin me nr 8 ju keni të bashkangjitur raportin e kërkuar me fotot si dhe vendimin e MPB-së,me nr:703/02.
Sa i përket baterisë ndriçuese ne kemi deklaruar se posedojmë të tillë dhe atë e gjeni tek follderi deklaratat e kompanisë ku kemi cekur:

Kompania e sigurimit fizik dhe elektronik " "Rojet e Nderit", është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tenderit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Spitalit të Përgjithshëm Prizren"

Ne deklarojmë se kemi pasje të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve konform kërkesës që të kemi pajisje të sigurisë si: Breza, Shufra, Pranga, Bateri ndriçuese,Radio Lidhje mobile dhe fikse etj, pasqyra për kontrollimin e automjeteve, si dhe uniformat e punës

Sa i përket pretendimit tuaj ku keni cekur se:Mungon Vendimi/Njoftimi i MPB për pajisje.
Përveç që nuk keni kërkuar një diçka të tillë ne e kemi bashkangjitur tek follderi i Licencave të Kompanisë dhe tek raporti i pajisjeve.

Sa i përket pretendimit tuaj ku keni cekur se:
Mungon licenca e menaxherit për Vëzhgim Elektronik nuk qëndron për faktin se Ne kemi Dorëzuar dy Menaxher të Sigurimit Fizik dhe dy menaxherë tjerë të Vëzhgimit Elektronik.

Provë te folderat me 5. Lista e menaxhereve te shërbimit themelor.pdf
6. Lista e stafit VEP.pdf.
Dhe siç ka cekur AK-ja se është dashur që të jetë i njejti person i licencuar në të dy fushat e sigurimit fizik dhe elektronik nuk qëndron sepse përveç se nuk e ka të cekur as në dosje as në njoftim për kontratë dhe sipas korrigjimit të dosjes të tenderit që ka ndodhur me datë: 23.10.2019.

Sa i përket pretendimit tuaj ku e keni cekur se çmimi për menaxher nuk mbulon kërkesën e AK-së , paga minimale prej 302 Euro dhe kontributet e paguara +5% t ë punëdhënsit sipas Aneksit t ë dosje së tenderit

Ky pretendim i juaji nuk qëndron pasi që ju keni kërkuar pagë 302.00 Euro Bruto vetëm për punëtor. Dhe çdo herë paga për menaxher është nën përgjegjësin e OE .

Pretendimi juaj se ne kemi dhënë çmimin 0.81 centë për orë pune nuk qëndron pasi që ne kemi llogaritur vetëm pagën e menaxherit, pasi që për atë pozicion nuk keni kërkuar pagë të caktuar por vetëm për punëtorët.
Sa për informim ne kemi pasur kontratë me ju që nga viti 2016 ku kanë qenë të njëjta kritere ku pagat kanë qenë të kërkuara vetëm për punëtor kurse për stafin menaxhues ne kemi vendosur një çmim simbolik dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje lidhur me mbarëvajtjen e punës.

Provë kopja e kontratës së vitit 2016.

Sa i përket pretendimit tuaj ku keni cekur se:
Mungon Certifikata e Qendrës së Kontrollit ky nuk është ndonjë element që duhet refuzuar ofertën pasi që ne jemi të licencuar dhe përderisa një kompani është e licencuar atëherë edhe Certifikata është e kuptueshme se ekziston.
Dhe sipas nenit 72 keni mundur ta kërkoni. neve po u'a bashkangjesim edhekopjen e Certifikatës e cila daton që nga viti 2012.

Panel i nderuar

Duke parë që AK-ja gjatë vlerësimit për gabime të vogla të cilat kanë mundur konform nenit 72 të sqarohen por me qëllime të caktuara ka bërë anashkalim të ofertës tonë dhe duke mos respektuar neni 6 të LPP-së për shfrytëzim sa më efikas të mjeteve të buxhetit.

Kërkojmë që t ë aprovoni kërkesën tonë dhe lenden ta ktheni në ri-vlerësim duke shpallur ofertën tonë me çmimin më të lirë të përgjegjshëm

Dëmet materiale

Mundësia e nënshkrimit të kontratës shpenzimet për përgatitje të ofertës si dhe koha humbur

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ë ulët

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Sipas vlerësimeve t ë AK-së operatori ekonomik "Rojet e Nderit" është eliminuar me arsyetimin se nuk plotëson kriteret teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosje të tenderit dhe njëkohësisht ofron çmim nen pragun kërkuar pasi që ofron çmim më të ulet se 302.00 Euro për menaxher të projektit dhe çmimi total i ofertuar është 383,019.30 Euro dhe ky çmim nuk i mbulon pagat e kërkuara prej 302.00 Euro për 29 punëtor duke përfshi edhe menaxherin projektit .

Sipas vlerësimit përfundimtar OE. "Rojet e nderit" nga ana e AK-së kualifikohet i papërgjegjshëm administrativisht dhe financiarisht me arsyetimin se:

- I mungon Certifikata e Qendrës s ë Kontrollit
- Mungon Raporti për pajisjet
- Mungon vendimi/ njoftimi i MPB për pajisje
- Mungon licenca e menaxherit te projektit për vëzhgim elektronik-
- Çmim për menaxher nuk e mbulon kërkesën e AK-së për pagën minimale prej 302. Euro dhe kontributet e paguara +5% të punëdhënësit të parapara sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit

Arsyetimi konkret ka qenë:
Paga 302.00€ + 5% kontributi i punëdhënësit prej 15.10 € = 317.10 € \ 29 punëtor = 9195,90 € + 18% TVSH prej 1,655,36€ = 10,851,16€ x 36 muaj = 390,641,83 €, kurse oferta juaj e përgjithshme është 383,01930 € andaj ne ketë vlere nuk mund ti paguani punëtoret e as kontributet e tyre dhe as TVSH-ne te përcaktuar sipas DT.

Duke u nisur nga këto arsyetime për kontratë rekomandohet OE "Commando" me çmim prej 390,697.96 Euro.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(N/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PBC"SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Duke iu referuar pretendimit ankimor nr.1 se AK ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së është i paqëndrueshëm për arsye se oferta e OE ankues në shume aspekte trajtohet e pa përgjegjshme, madje edhe çmimi i ofruar konsiderohet çmim i papranueshëm sepse OE ankues ofron çmim nën pragun e kërkuar.

Kërkesë e dosje së tenderi ka qenë që paga bruto për 29 punëtor përfshi edhe menaxherin projektit nuk mund të ofrohet nën pragun prej 302.00 Euro, në të kundërtën nënkupton që çdo ofertë nën ketë prag do të eliminohet nga konkurrenca, andaj mos ofrimi i dëshmimeve kualifikuese dhe ofrimi i çmimit nën pragun e kërkuar nënkupton se OE ankues me të drejt është eliminuar nga konkurrenca, dhe me ketë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje te dispozitave të nenit 6 te LPP-së, sepse kemi të bëjmë me një ofertë e cila nuk i plotëson kërkesat e parashtruara në dosje.

Pretendimi numër 2
Gjithashtu Eksperti Shqyrtues vlerëson se AK nuk ka bërë asnjë lloj favorizimi apo diskriminimi në favor të njërës apo tjetrës palë, pasi qe vlerësimet janë bërë mbi bazën e kritereve të përcaktuar në dosje të tenderit dhe ndër të tjera OE ankues nuk e ngrit asnjë pretendim konkret se cilat mund të jenë favoret qe i janë bere OE te rekomanduar apo c`fare diskriminimesh janë bërë gjatë vlerësimit të ofertave , kur dihet se oferta e OE ankues në ofertë nuk përmban Certifikate të Qendrës se Kontrollit si dhe nuk ofron licence të menaxherit te projektit për vëzhgim elektronik

Pretendimin nr. 3 qe ka t bëje me mungesën e transparence lidhur me ketë aktivitet të prokurimit nuk është ngritur asnjë pretendim i mundshme për mos ofrim të informatave apo qasje ne aktivitet te prokurimit, pasi qe tani dihet se aktiviteti është zhvilluar përmes platformës elektronike e-prokurimit

Pretendimi nr.4
Ky pretendim k a të bej me atë se AK nuk e ka berë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ne përputhje me

dispozitat e nenit 59 e LPP-së ,dhe lidhur me keto pretendime Eksperti konstaton si në vijim:

- OE ankues I mungon Certifikata e Qendrës se Kontrollit ofron Licencë për trajnime themelore profesionale, Licence për shërbime themelore të sigurtit, Licence për shërbime te vëzhgimit elektronik të pronës, Licence për shërbime te sigurimit te tubimeve publike por jo edhe certifikatën e Qendrës s kontrollit ashtu siç është kërkuar në dosje te tenderit.

  Provë:Kërkesat e nenit e II.2.4- Kapaciteti teknik dhe profesionalë i pacaktuara ne njoftim për kontratë dhe në dosje te tenderit.

- OE ankues nuk posedon Licence të menaxherit të projekti për vëzhgim elektronik pasi qe menaxheri projektit ka qenë i caktuar z. Fidaim Mjeku i cili ka autorizim nga ARKEP për autorizim individual për radio frekuenca por jo për vëzhgim elektronik të parapare sipas Kërkesës nr. 11 të kërkesave për kualifikim teknik dhe profesional.

- Arsyeja e anulimit se nuk ofron pagë për menaxherin e prokurimit sipas kërkesave te AK-së sipas Ekspertit Shqyrtues edhe ky arsyetim për eliminim është i bazuar sepse AK tek lista çmimeve ka kërkuar çmim për 28 punëtor dhe një menaxher me pagë minimale prej 302.00 Euro për muaj dhe nëse i referohemi formularit të çmimit shihet se çmimi për menaxher është nen pragun e kërkuar madje paga menaxherit të projektit është me e ulet se sa paga e punëtorit, dhe çmimi i këtij pozicioni ka ndikuar qe OE ankues të ketë oferte nen pragun e kërkuar pasi qe pragu minimal për terë vlerën ofertës është 390,641.83 Euro, ndërsa çmimi i OE ankues është 383,019.30 Euro për tri vite

Lista e çmimeve

NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NR. PUNËTOREVE	NJËSIA	SASIA E VLERSUAI OREVE	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH €	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH	ÇMIMI TOTA ME TVSH €
1	Punëtor të sigurimit	28	Orë	177,408	1.81 €	2.13 €	377,879.04 €
2	Menaxheri	1	Orë	6,346	0.69 €	0.81 €	5,140.26 €
ÇMIMI TOTAL ME TVSH :							383,019.30 €

Eksperti shqyrtues vlerëson se ne kuptim te nenit 72 të LP-se mund te kërkoj informua sqaruese lidhur me pajisjet dhe për Certifikatën e Qendrës se Kontrollit, por oferta e OE ankues konsiderohet e papërgjegjshme në aspektin teknik dhe profesional si ne aspektin financiar pasi qe pasi që menaxheri i projektit nuk posedon licence për vëzhgim elektronik dhe njëkohësit çmimi i ofruar është nen pragun minimal te kërkuar. Ketë e dëshmon edhe çmimi i ofruar ku një ore pune për punëtoret oferohet me 2.13 €, ndërsa pagen e menaxherit ofron çmim është 0.81 për orë qe do thë se paga e tij bruto llogarite të jetë 142.56 Euro ne muaj që dë të thotë se është nen pragun kërkuar

Pretendimi nr 5

Gjithashtu e dhe ku pretendim është i pabazuar për arsye se sipas dispozitave te LPP-s në rastet kur kriter vlerësimi është tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulet nënkupton se për kontratë duhet të rekomandohet OE me çmim më të ulet përkundrejt ofertës se tij të përgjegjshëm, në të kundërtën edhe pse ofron çmim me të lirë nënkuptohet se duhet eliminuar nga konkurrenca.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE të refuzohet e pa bazuar dhe njëkohësisht të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues,- Spitali Rajonal Prizren.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues: "Rojet e nderit "